

EPOKA ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6180
E mërkurë, 2 dhjetor 2020
çmimi 0.40

Qeveria, masa të reja
kundër Covidit për
festat e fundvitit | FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", FATMIR REXHEPI | FAQE 4-5

LDK-së I DUHET NJË LIDERSHIP I RI

Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Fatmir Rexhepi, i ka ftuar strukturat udhëheqëse të partisë që të reflektojnë ndaj rezultatit të zgjedhjeve në Podujevë dhe kërkesave të kohës. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se ka ardhur koha për ndryshimin e lidershit të LDK-së. Rexhepi i ka bërë thirrje liderit të partisë që ta thërrasë Kuvendin e Përgjithshëm të LDK-së i cili në janar do ta zgjidhte liderin e ri të kësaj partie. Ai ka vlerësuar se kjo thirrje e tij duhet të kuptohet si kërkesë e kohës. Sipas Rexhepit, vetëm me një leadership të ri LDK-ja do të bashkohej dhe do të ishte e gatshme për zgjedhjet e reja. Rexhepi në këtë intervistë ka folur edhe për zgjedhjen e presidentit të ri dhe për mundësinë e zgjedhjeve të reja

OPINION

LIRIA KA
EMËR

HIPOKRIZIA E LUFTËS NË
PAQE PËRBALLË LUFTËS PËR
LIRINË DHE SHTETËSINË E
KOSOVËS | F. 11

Fitim RIFATI

AKTUALE

BORRELLI: NUK MUND TË JEMI
AKTORË GLOBALË NËSE NUK I
ZGJIDHIM PROBLEMET NË
BALLKAN | F. 2

NDËRRON JETË NËNKRYETARI I
SHKUPIT, KOSOVA NGUSHËLLON
FAMILJEN MALIQI | F. 2



EKONOMI

KONTRATA ME "CONTOUR
GLOBAL" SHKON NË ARBITRAZH | F. 9

DEPONITË ILEGALE PO
SHKATËRROJNË MJEDISIN NË
KOSOVË | F. 9

KULTURË

AMBASADORI GJERMAN:
DO TA MBËSHITESIM MKRS-NË
NË REALIZIMIN E PROJEKTEVE
KULTURORE | F. 6

PARTITË POLITIKE, ENDE LARG KONSENSUSIT PËR DIALOG

| FAQE 3

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka zhvilluar të martën diskutimin online "Kuvendi përballë dialogut Kosovë - Serbi", në të cilin takim virtual deputetët kanë shprehur perspektivën e tyre lidhur me dialogun Kosovë - Serbi në përgjithësi, si dhe për rolin që Kuvendi duhet të ketë në raport me këtë proces. Edhe gjatë këtij diskutimi u shënuan dallimet e



mëdha që ekzistojnë në mes të partive politike parlamentare lidhur me këtë proces



GAZETARJA E 'EPOKËS SË
RE', ALBULENA MAVRAJ,
FITON ÇMIMIN E PARË PËR
GAZETARI PËR ENERGJI
DHE AMBIENT | FAQE 7

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 755
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 700
E-mail: renova@mt.net.mk
Mob: +377 44 501 269

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOV.
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Borrelli: Nuk mund të jemi aktorë globalë nëse nuk i zgjidhim problemet në Ballkan

BRUKSEL, 1 DHJETOR - Përfaqësuesi i lartë i Bashkimit Evropian, Josep Borrell, ka thënë të martën se zgjidhja e problemeve në Ballkan është një përgjegjësi e Bashkimit Evropian dhe se nga kjo varet edhe roli global i BE-së. "Nëse nuk mund t'i zgjidhim problemet në Ballkan atëherë si mund të jemi aktor i rëndësishëm global", ka thënë Borrelli.

Ai i bëri komentet në një debat kushtuar dhjetëvjetorit të krijimit të Shërbimit të Veprimit të Jashtëm të BE-së, një lloj shërbimi i përbashkët diplomatik evropian, ku morën pjesë edhe dy paraardhës të tij, Javier Solana dhe Federica Mogherini.

Borrell foli për dialogun në mes

të Kosovës dhe Serbisë dhe përsëriti se ky problem duhet të zgjidhet në kuadër të perspektivës evropiane. Në anën tjetër, ai mirëpriti edhe gatishmërinë e Shteteve të Bashkuara për të ndihmuar në këtë proces. "Na vjen mirë që ShBA-ja dëshiron të ndihmojë, por është BE-ja ajo që udhëheq këtë proces. Vetëm BE-ja mund ta paraqesë ofertën e rëndësishme për njerëzit atje dhe ajo është perspektiva evropiane. Në kuadër të kësaj perspektive duhet të zgjidhet problemi", ka thënë Borrelli. Ai edhe një herë ka shprehur kënaqësinë për rifillimin e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë, që në fillim të mandatit të tij.

Javier Solana, ish-sekretar i

përgjithshëm i NATO-s dhe përfaqësuesi i parë i lartë i BE-së prej kur është krijuar kjo pozitë, ka thënë se problemi në mes të Kosovës dhe Serbisë duhet të zgjidhet përmes dialogut, por edhe duke i ofruar një rrugë më të shpejtë Serbisë drejt BE-së. Këtë Solana e ka lidhur edhe me ndikimin e Rosisë në rajon e sidomos në Serbi.

Pas një ndërprerjeje prej më shumë se 20 muajsh, procesi i dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë, me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian, rinisi më 16 korrik të vitit 2020.

Në takimin e parë kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti dhe presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, u tha se biseduan për çështjen e të pagjeturve, të



zhvendosurve dhe për çështjet ekonomike. Hoti dhe Vuçiqi, po ashtu, janë takuar edhe në muajin shtator. Por, që atëherë nuk ka pasur më raunde të reja

të bisedimeve në nivelin e lartë dhe BE-ja ka thënë se bisedimet do të rinisin pasi të lejojnë kushtet për shkak të pandemisë së koronavirusit.

Ndërron jetë nënkryetari i Shkupit, Kosova ngushëllon familjen Maliqi



SHKUP, 1 DHJETOR - Ka ndërruar jetë nënkryetari i Shkupit, Enver Maliqi. Kryetari i Parlamentit të Maqedonisë së Veriut, Talat Xhaferi, ka thënë se është i trishtuar dhe i pikëlluar nga lajmi i hidhur për largimin nga kjo botë të Enver Maliqit, nënkryetar i qytetit të Shkupit, afarist i respektuar, konsull nderi i Meksikës, humanist dhe mbështetës i njerëzve në nevojë.

Edhe kryetari i BDI-së, Ali Ahmeti, ka thënë se Enver Maliqi çdoherë do të mbetet në kujtimet e tij si një atdhetar dhe

humanist i madh i cili me veprat e veta ka lënë shumë gjurmë në vend dhe në rajon. Edhe në Kosovë i kanë shprehur ngushëllime familjes Maliqi. Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, në emër të komunitetit të biznesit ka shprehur ngushëllimet me të sinqerta për familjen Maliqi. "Enveri ka qenë anëtar i devotshëm dhe përkrahës i fuqishëm i Odës Ekonomike të Kosovës. Humbje e madhe për të gjithë miqtë nga Kosova, Maqedonia, Shqipëria dhe më gjerë", ka shkruar Rukiqi në

llogarinë e vet në "Facebook". Edhe kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka shkruar për vdekjen e nënkryetarit të Shkupit, Enver Maliqi. "Pikëllues lajmi për vdekjen e Enver Maliqit, nënkryetar i Shkupit. Ngushëllime për familjen, miqtë, qytetarët dhe institucionet e Bashkisë së Shkupit. U prehtë në paqe!", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook". Edhe ambasadori i Kosovës në Maqedoninë e Veriut, Gjergj Dedaj, ka ngushëlluar familjen Maliqi.

Gjykata e Apelit përgjysmon dënimin ndaj Darko Tasiqit për krime lufte

PRISHTINË, 1 DHJETOR - Gjykata e Apelit në Kosovë ka njoftuar të martën se e ka miratuar pjesërisht ankesën e të akuzuarit Darko Tasiq lidhur me aktgjykimin e Gjykatës Themelore të Prizrenit të datës 22 qershor 2020, sipas të cilit, ai është dënuar me 22 vjet burgim me akuzat për krime lufte kundër popullatës civile shqiptare. Në vendimin e Gjykatës së Apelit është thënë se vendimi paraprak i gjykatës në Prizren është ndryshuar vetëm sa i përket cilësimit juridik të veprës penale dhe vendimit mbi dënim. Për pasojë, dënimi ndaj Tasiqit është ndryshuar nga 22 në 11 vjet burgim, duke përfshirë kohën e kaluar në

paraburgim. "Gjykata e Apelit gjeti se në veprimet e të akuzuarit, të ndërmarra gjatë luftës së fundit në Kosovë, konkretisht ndërmjet datës 25-27 mars 1999, përmbushen të gjitha elementet e veprës penale 'krime lufte kundër popullsisë civile' nga neni 142, lidhur me nenin 22 të Ligjit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (LPRSFJ), vepër kjo e sanksionuar edhe sipas nenit 3 Konventës së Gjenevës dhe protokollit të dytë të saj", është thënë në njoftimin e Gjykatës së Apelit.

Më 22 qershor të këtij viti Tasiq është shpallur fajtor për krime lufte ndaj popullatës civile në

vitin 1999 në Krushë të Vogël të Prizrenit. Sipas aktgjykimin të Gjykatës në Prizren, Tasiq ishte shpallur fajtor për pikën dy të aktakuzës për përdhosjen e trupave të pajetë të personave të paidentifikuar, duke i djegur ata dhe duke i hedhur në Lumin Drin.

Tasiq ishte shpallur fajtor edhe për akuzën që thotë se në mars të vitit 1999 në Krushë të Vogël, si pjesëtar i forcave rezervë të Policisë së Republikës Federative të Jugosllavisë, në bashkëkryerje me persona të tjerë, identiteti i të cilëve nuk është arritur të përcaktohet, Tasiq ka marrë pjesë në konfiskim të pasurisë, plaçkitje, shkatërrim të paligjshëm dhe të



qëllimshëm të pasurisë (djegien e shtëpive) që nuk justifikohet me nevojat ushtarake. Darko Tasiq pati mohuar fajësinë dhe është mbrojtur në

heshtje. Sipas Fondit për të Drejtën Humanitare, gjatë konfliktit të viteve 1998-'99 në Kosovë janë vrarë më shumë se 13 500 persona.

Partitë politike, ende larg konsensusit për dialog

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka zhvilluar të martën diskutimin online “Kuvendi përballë dialogut Kosovë - Serbi”, në të cilin takim virtual deputetët kanë shprehur perspektivën e tyre lidhur me dialogun Kosovë - Serbi në përgjithësi, si dhe për rolin që Kuvendi duhet të ketë në raport me këtë proces. Edhe gjatë këtij diskutimi u shënuan dallimet e mëdha që ekzistojnë në mes të partive politike parlamentare lidhur me këtë proces

EPOKA ERE**Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 1 DHJETOR- Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka zhvilluar të martën diskutimin online “Kuvendi përballë dialogut Kosovë - Serbi”, në të cilin takim virtual kanë marrë pjesë deputetë të grupeve parlamentare të Kuvendit të Kosovës si dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

Në hyrje të diskutimit, Jeta Krasniqi, menaxhere e projektit në KDI, ka folur për punën dhe aktivitetet e KDI-së në funksion të rritjes së transparencës së procesit të dialogut, si dhe llogaridhënies së ekzekutivit karshi publikut për këtë çështje. Gjatë diskutimit u prezantua analiza “Fuqizimi i mbikëqyrjes parlamentare ndaj dialogut Kosovë - Serbi”, e cila paraqet një pasqyrë të asaj se si e ka ushtruar Kuvendi rolin mbikëqyrës ndaj dialogut deri më tani, si dhe ofron rekomandime konkrete për deputetët e Kuvendit për ta përbushur në mënyrë më efektive mandatin e tyre mbikëqyrës ndaj këtij procesi.

Violeta Haxholli, autore e punimit në fjalë, ka vlerësuar nevojën për fuqizimin e Kuvendit si organi më i lartë mbikëqyrës i politikës së jashtme dhe dialogut me Serbinë, duke qenë se dialogu është një nga proceset më të rëndësishme në të cilat po kalon vendi. Ajo ka theksuar se procesi i dialogut me Serbinë vazhdon të jetë një nga shkaqet kryesore të mospajtimeve dhe debateve të ashpra në Kuvend. “Duke pasur parasysh se çështja e dialogut me Serbinë shkon përtej interesave partiake, partitë parlamentare duhet të tentojnë të ndërtojnë një qëndrim të përbashkët lidhur me qasjen ndaj Serbisë dhe dialogut në veçanti. Një qëndrim i përbashkët i një spektri më të gjerë politik do ta fuqizonte vetë rolin mbikëqyrës të Kuvendit ndaj procesit të dialogut” ka thënë Haxholli.

Në anën tjetër, deputetët e Kuvendit shprehën perspektivën e tyre lidhur me dialogun Kosovë - Serbi në përgjithësi si dhe rolin që Kuvendi duhet të ketë në raport me këtë proces. Edhe gjatë këtij diskutimi u shënuan dallimet e mëdha që ekzistojnë në mes të partive politike parlamentare lidhur me këtë proces.

Fitore Pacolli-Dalipi nga grupi parlamentar i Lëvizjes

Vetëvendosje ka thënë se mbikëqyrja e Kuvendit karshi qeverisë nuk ka mundur të jetë efikase për shkak të qasjes së qeverisë, e cila ka raportuar sa për sy e faqe. Sipas saj, në shumë raste ka pasur kushtëzim të raportimeve të ministrave apo kryeministrit qoftë në kohëzgjatje apo përmbajtje të pyetjeve.

Pacolli-Dalipi ka thënë se në situatën kur Kuvendi është jofunksional duhen zgjedhje të reja parlamentare, ndërsa deri në formimin e një qeverie të re legjitime të ndërpritet procesi i dialogut.

Ndërsa Faton Bislimi, deputet nga radhët e grupit parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, ka vlerësuar se procesi i dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë duhet të jetë barrë e të gjitha institucioneve dhe partive politike në vend, e jo vetëm e qeverisë apo ndonjë partie të caktuar. Bislimi ka theksuar nevojën për formimin e një komisioni të veçantë për procesin e dialogut, ku do të përfaqësoheshin të gjitha grupet parlamentare, e që si mekanizëm do të ishte linja e parë e frontit mbikëqyrës të Kuvendit në raport me qeverinë dhe ekipin negociues.

Edhe Blerita Deliu-Kodra nga radhët e subjektit tjetër opozitar, Partia Demokratike e Kosovës, deklaroi se procesi i dialogut ka humbur vëmendjen e cila është zhvendosur sidomos pas zhvillimeve të fundit me Gjykatën Speciale.

Deputetja Deliu-Kodra ka ritheksuar se me brishtësinë e saj qeveria nuk ka asnjë mundësi të arrijë një marrëveshje ndërkombëtare që mund të sillte dhe aprovohet në Kuvend, prandaj është i domosdoshëm, sipas saj, një kompromis mes forcave politike në vend. “Raportimet e ekzekutivit kanë qenë më tepër sa për të kryer një obligim, por ne si deputetë nuk kemi marrë asgjë konkrete sa iu përket temave të diskutuara apo të ngritura nga deputetët”, ka deklaruar ajo.

Në anën tjetër, Time Kadrijaj, deputete e AAK-së, njëkohësisht kryetare e Komisionit Parlamentar për Punë të Jashtme, ka potencuar se pas zhvillimeve të fundit, dialogu duhet të ndërpritet deri në krijimin e kushteve më të mira për rifillimin e tij. Sipas saj, nuk mund të vijohet me një proces deri të dialogu derisa në Serbi janë duke



u kryer zharrosjet e trupave të personave të pagjetur.

Nga radhët e pjesëmarrësve të tjerë të këtij diskutimi u ngritën për diskutim çështja e formimit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, temat dhe çështjet që mund të arrihet konsensusi, si dhe se çfarë kanë bërë institucionet tona për faktin që gati 1/3 e personave të pagjetur janë joshqiptarë. Panelistët u pajtuan që

Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe nuk mund të formohet pa qenë në përputhje të plotë me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, ligjeve dhe Kushtetutës së Kosovës, ndërsa kërkuan që çështja e personave të pagjetur të zgjidhet sa më shpejt, pavarësisht prej etnisë së tyre, duke kërkuar nga bashkësia ndërkombëtare t'i bëjë presion Serbisë, e cila duhet ta zbulojë vendndodhjen e këtyre varrezave

masive.

Diskutimi u organizua në kuadër të projektit “Promovimi i një procesi të mirinformuar dhe pjesëmarrës në fazën finale të dialogut Kosovë - Serbi”, i mbështetur nga Ambasada e Zvicrës dhe Ambasada Gjermane në Kosovë. Ky diskutim u zhvillua në respektim të plotë të masave të institucioneve relevante për parandalimin dhe luftimin e pandemisë.

Fotolajm



Komuna e Prishtinës po bëhet gati për festat e fundvitit



FLET PËR “EPOKËN E RE”, FATMIR REXHEPI

LDK-së I DUHET NJË LIDERSHIP I RI

Deputeti i Lidhjes Demokratike i Kosovës (LDK), Fatmir Rexhepi, i ka ftuar strukturat udhëheqëse të partisë që të reflektojnë ndaj rezultatit të zgjedhjeve në Podujevë dhe kërkesave të kohës. Në këtë intervistë dhënë gazetës “Epoka e re”, ai ka thënë se ka ardhur koha për ndryshimin e lidershipit të LDK-së. Rexhepi i ka bërë thirrje liderit të partisë që ta thërrasë Kuvendin e Përgjithshëm të LDK-së i cili në janar do ta zgjidhte liderin e ri të kësaj partie. Ai ka vlerësuar se kjo thirrje e tij duhet të kuptohet si kërkesë e kohës. Sipas Rexhepit, vetëm me një lidership të ri LDK-ja do të bashkohej dhe do të ishte e gatshme për zgjedhjet e reja. Rexhepi në këtë intervistë ka folur edhe për zgjedhjen e presidentit të ri dhe për mundësinë e zgjedhjeve të reja

“Epoka e re”: Çfarë ka ndikuar në këtë rezultat?

Rexhepi: Mund të jenë shumë faktorë. Mund të jetë një reagim i qytetarëve të Llapit për shkak të qeverisjes së gjatë të LDK-së, jo se Agimi nuk ka punuar mirë, sepse unë besoj se Agimi ka punua mirë. Mirëpo koha e gjatë në pushtet e bën të vetën. Në anën tjetër, mund të jetë një lloj reagimi i tyre për lëshimin e mandatit të kryetarit pa e pyetur elektoratin. Pra, mund të jenë disa faktorë, sepse Agimi ka punuar kohë të gjatë dhe vazhdimisht ka gëzuar besimin e tyre. Sido që të jetë, ky rezultat për Degën e LDK-së në Podujevë dhe për LDK-në në përgjithësi është një mesazh

për lidershipin e LDK-së se duhet të ulet dhe të diskutojë në forumet e partisë për ditë më të mira. Pra, të bëhet një vlerësim dhe gjykim i drejtë i situatës dhe të merren veprime politike që i duhen partisë. Ky është një mesazh që sjell përgjegjësi të madhe para lidershipit të LDK-së.

“Epoka e re”: Çfarë veprime duhet të ndërmerret tani lidershipi i LDK-së?

Rexhepi: Ky mund të jetë vetëm një mesazh i parë. Mos të pritët thellimi i krizës, pra që të kemi një vlerësim sa më të drejtë. I takon udhëheqjes së partisë që të mendojë për strategjinë dhe të veprojë në përputhje me rrethanat dhe

humbur zgjedhjet në Podujevë. Si e keni parë këtë rezultat?

Rexhepi: Natyrisht se këtë rezultat nuk e kemi pritur mirë, sepse çdokush i gëzohet fitores së partisë së tij dhe askush nuk

i gëzohet humbjes. Kjo është një postulat edhe në politikë edhe në jetën private. Sido që të jetë, ishte një mandat që iu ka besuar Lëvizjes Vetëvendosje dhe kandidatit të tyre.

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 1 DHJETOR -

“Epoka e re”: Z. Rexhepi, pas disa dekadave LDK-ja ka



kërkesat e reja. Të shihet se çka po kërkohet sot dhe cili lidhshipi po kërkohet në LDK. A duhet të përmbillet lidhshipi aktual apo duhet të reformohet lidhshipi i LDK-së. Pra të gjitha këto duhet të analizohen dhe të gjendet mënyra më e mirë. Besoj se LDK-ja dhe lidhshipi i saj, i cili, për fat të keq është shëndetlig, duhet ta kuptojë se gradualisht duhet ta lirojë detyrën.

“Epoka e re”: Çfarë duhet të bëjë tani lidhshipi i LDK-së?

Rexhepi: Ndoshta është e rrugës që më 23 dhjetor të paralajmërohet një kuvend i ri i LDK-së, pra janar, ku do ta kishim zgjedhur një lidhship të ri të LDK-së, cili duhet ta bartë një përgjegjësi të madhe, pavarësisht se a do të kemi zgjedhje apo jo. Duhet t’ia bëjmë një falënderim të madh lidhshipit aktual në Kuvendin e LDK-së dhe në janar të kemi një lidhship të ri të LDK-së. Thirrja ime është se LDK-ja duhet t’iu përgjigjet kërkesave të kohës dhe jo që kemi diçka për lidhshipin aktual.

“Epoka e re”: Pra, mendoni se ndërrimi i lidhshipit dhe reformimi i kësaj partie e këndell LDK-në?

Rexhepi: Ne kemi krizë të thellë politike. Nuk them se këtë krizë e ka krijuar lidhshipi aktual. Dinamika e ngjarjeve kërkon ndryshime, sepse në

kemi një lidhship të hendikepuar në aspektin shëndetësor. Përkundër krejt angazhimeve të mëdha që ka bërë deri më tani, mendoj se Kuvendi i LDK-së më 23 dhjetor duhet të jetë një thirrje për krejt LDK-në që në muajin janar Kuvendi i LDK-së ta zgjedhë një lidhship të ri. Ka ardhur koha për këtë ndryshim. Besoj se kjo është në të mirën e LDK-së dhe kjo nuk duhet të keqkuptohet, por të kuptohet drejt. Edhe nga zgjedhjet në Podujevë dhe nga vetë kërkesat e kohës që po dalin, duhet t’i marrim si mesazhe që t’i japim një shans të re, ta kemi një lidhship të ri i cili do të mirëpritet nga rinia e LDK-së dhe nga të gjithë ata që e duan LDK-në. Vetëm në këtë mënyrë do të mund të bashkoheshim, sepse jemi bërë disa copa brenda në Kosovë dhe në diasporë. Duhet ta bëjmë një bashkim, ta zgjedhim një lidhship të ri dhe të ecim përpara.

“Epoka e re”: Kush do të mund ta udhëhiqte LDK-në?

Rexhepi: Duhet të thirret Kuvendi i LDK-së. Kryesia dhe lidhshipi aktual duhet ta vlerësojnë këtë moment. Duhet ta falënderojmë lidhshipin aktual për gjithë kontributin që ka dhënë deri më tani. Them se është rendi ta zgjedhim një lidhship të ri. Unë para dhjetë vjetëve kam qenë një kuadër që kam kërkuar që

Isa Mustafa të jetë kryetar i LDK-së, sepse koha ka kërkuar atëherë që të jetë në krye të LDK-së. Edhe sot, për të njëjtat principe, për arsyet që i përmenda, mendoj se profa duhet ta thërrasë kuvendin e partisë dhe më 23 dhjetor ta paralajmërojë hapjen e garës për një lidhship të ri. Mendoj se LDK-ja i ka 4-5 kuadro që mund ta udhëheqin LDK-në. Të bëhet një garë demokratike dhe rreth fituesit të vazhdojmë përpara. Kjo do ta kthente besimin e LDK-së të te rinjtë dhe te të gjithë simpatizuesit e LDK-së që e presin ndryshimin në parti.

“Epoka e re”: Kjo garë do të duhej të ishte e hapur edhe për Vjosa Osmanin?

Rexhepi: Mendoj se ne nuk kemi njerëz për të humbur. Ajo ka kontribute të jashtëzakonshme në LDK. Vjosa Osmani është vlerë e madhe për LDK-në sikurse janë edhe të tjerat që janë larguar. Nëse e duam forcimin e LDK-së atëherë duhet bashkimi nga i cili duhet të vijnë në shprehje kuadrot e reja dhe kuadrot me përvojë. Duhet të kemi një kuvend të ri i cili do të sjellë lidhship të ri dhe energji të re. Në këtë mënyrë do të tregonim një mesazh të fuqishëm se LDK-ja ka potencial për t’iu përgjigjur kërkesave të kohës. Tek atëherë do të mund të shkonim në

zgjedhje. Nuk duhet t’i presim zgjedhjet nacionale pa i bërë këto ndryshime.

“Epoka e re”: Tani Kosova nuk ka president. Si duhet të veprojnë partitë politike për zgjedhjen e presidentit të ri?

Rexhepi: Mendoj se të gjitha partitë politike parlamentare duhet të ulen dhe të arrijnë një marrëveshje politike për zgjedhjen e presidentit. Duhet ta ndajmë çështjen e presidentit prej qeverisë. Çështja e presidentit nuk duhet të përzihet me çështje të reja, sepse kjo do të na riciklojë sërish krizën për presidentin. Ftoj liderët e të gjitha partive që të ulen dhe ta bëjnë një kompromis për pozitën e presidentit. Të gjithë e kanë për borxh që ta gjejnë një presidenti konsensual.

“Epoka e re”: Po për zgjedhje të reja, a duhet të merren vesh partitë?

Rexhepi: Partitë politike duhet të ulen dhe të merren vesh edhe për zgjedhje. Të merren vesh nëse ato duhet të mbahen në pranverë, pas gjashtë muajve apo pas një viti. Me rëndësi është që çështjen e presidentit duhet ta heqim nga rendi i ditës bashkërisht. Edhe pas zgjedhjeve të reja duhet të ulemi dhe ta bëjmë të njëjtrën procedurë. Tani Kuvendin e kemi legjitim dhe partitë politike duhet të gjejnë zgjidhje për presidentin.

Qeveria, masa të reja kundër Covidit për festat e fundvitit

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 1 DHJETOR - Gjysmëvjetori i parë i vitit shkollor në Kosovë do të përfundojë më 18 dhjetor, ndërsa i dyti do të fillojë më 18 janar, ka thënë kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, pas mbledhjes së komitetit për menaxhimin e pandemisë Covid-19. Ai ka thënë të martën se kompensimi i orëve të humbura do të bëhet gjatë pushimeve pranverore. Kryeministri Hoti ka thënë se situata me pandeminë në Kosovë është mjaft serioze, por nën kontroll. Pas takimit të komitetit, Hoti ka thënë se nuk do të ketë masa shtesë, mirëpo do të vazhdojnë të jenë në fuqi ato aktuale, të cilat do të kërkohen të zbatohen në mënyrë rigorozë. Rreth dy javë më parë Qeveria e Kosovës ka miratuar masat e

reja për parandalimin e përhapjes së Covid-19, duke kufizuar lëvizjen e lirë në disa komuna nga ora 19:00 deri në orën 5:00 të mëngjesit. “Në bazë të vlerësimit të institucioneve kemi vendosur nën kontroll zgjerimin më tutje të pandemisë”, ka deklaruar kryeministri Hoti. Megjithatë, Kosova do të vendosë disa masa të reja për festat e fundvitit. Hoti ka thënë se këto masa do të vendosen nga institucionet e Kosovës në javën e ardhshme. Duke folur për situatën epidemiologjike, kryeministri Hoti ka theksuar se deri më tani janë testuar 145 mijë qytetarë, ndërsa 38 për qind e tyre kanë dalë pozitivë, ndërsa rreth 62 për qind janë shëruar. Kreu i qeverisë ka njoftuar se nga java e ardhshme do të fillojnë testimet ndaj koronavirusit edhe në shtëpi dy rajone, por pa saktësuar se në cilat.



Totaj dhe Hoxha: Komuna e Prizrenit përdhosi figurën e Skënderbeut

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 1 DHJETOR- Nën kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), njëkohësisht kryetari i Degës së PDK-së në Prizren, Shaqir Totaj, i shoqëruar nga deputetja Eliza Hoxha, kanë mbajtur sot një konferencë për media.

Gjatë kësaj konference, nënkryetari i PDK-së, Shaqir Totaj, ka kritikuar Komunën e Prizrenit për të gjithë procesin në lidhje me vendosjen e shtatores së Gjergj Kastriotit Skënderbeut. Totaj ka thënë se duke filluar nga vlera artistike e shtatores e deri te lokacioni ku komuna ka vendosur shtatoren e Skënderbeut, janë jo të denja për heroin tonë kombëtar. “E para, lokacioni i përzgjedhur nuk është i denjë për vendosjen e shtatores së Skënderbeut. Ai është i izoluar dhe shumë hapësirë e fshehur e qytetit. E dyta, për shkak të trafikut të dendur në atë rrethrotullim ku është vendosur shtatorja, shumë lehtë mund të shkaktohen aksidente dhe rrezikohet jeta e vizitorëve të mundshëm. E treta, dega e PDK-së në Prizren përmes asambleistëve të saj në fazën e parë, para se të merret vendimi, ka tërhequr vëmendjen për lokacionin jo adekuat dhe ka kërkuar lokacion tjetër më të përshtatshëm por që është injoruar nga kryetari Mytaher Haskuka”, ka thënë Totaj.

Nën kryetari Totaj ka shtuar se pushteti lokal i Vetëvendosjes me kokëfortësinë e vet, duke injoruar tërësisht sugjerimet dhe rekomandimet nga qytetarët dhe opozita, po tregohet

mospërfillëse edhe ndaj figurave të tilla të historisë kombëtare sikur që është Skënderbeu. “Madje kryetari Mytaher Haskuka u përpoq një ditë më herët nëpër studio televizive ta largoj përgjegjësinë nga vetja duke gënjer publikisht se ai nuk ka qenë shumë në rrjedha për shtatoren sepse për pamjen e tij finale është përkujdesur një shoqatë e komuna ka caktuar veç lokacionin. Keqqueverisja përveç pothuajse të gjitha fushave tjera ku ka dështuar, shkon aq larg sa që tallet edhe me vet figurën e Skënderbeut e rrejdhimisht edhe me historinë e ndryshme kombëtare simbol i të cilës është vet Gjergj Kastrioti”, ka shtuar ai. Totaj ka bërë me dije se PDK-ja në Prizren do të fillojë me mbledhjen e nënshkrimeve për një seancë të jashtëzakonshme të Asamblesë Komunale ku do të kërkohej rimodelim i shtatores së Skënderbeut dhe ndryshimin e lokacionit, sepse figura e tij meriton lokacionin më të mirë të qytetit.

Ndërkohë, deputetja e Kuvendit të Kosovës nga radhët e PDK-së, Eliza Hoxha, ka thënë se veprat e artit publik zakonisht janë produkt i relacioneve të pushtetit, relacioneve shoqërore, identitare të përmbledhura në reflektimin e kujtesës kolektive brenda strukturës hapësirë urbane. “Si të tilla, këto projekte duhet të kalojnë nëpërmjet një debati publik jo vetëm në raport me vet monumentin por edhe me vet lokacionin ku do të vendoset ajo. Andaj, për të pasur besimin e qytetarëve, arti publik duhet të synojë të përsosur në aspektin e reprezentimit.”, ka thënë Hoxha.



Sipas deputetes Hoxha, vendosja e Skënderbeut në një rreth rrotullim, i pamundëson qytetarit prizrenas të jetë pranë tij, ta përjetojë atë pa zhurmë akustike dhe vizuale për shkak të kontekstit të dhënë. “Përjetimi kryesor do të jetë nga makinat në lëvizje. Trajtimi i tillë i hapësirës urbane nuk prodhon asgjë më shumë se sa momente monumentaliteti për konsum ditor dhe konsum politik. Casjet të tilla si këto kanë krijuar vazhdimisht hapësira monumentale të cilat nuk i

ndiejmë si pjesë të jetës sonë të përditshme dhe i vizitojmë sa për të thënë e për të bërë një foto në ditën e caktuar”, ka shtuar deputetja Hoxha. Deputetja Hoxha ka thënë se e kaluara duhet të bashkëtojë me ne dhe si e tillë të formësojë përditë krenarinë tonë kolektive për veten dhe identitetin tonë. Sipas saj, është e turpshme dhe e dhimbshme se si e kaluara jonë dhe akterët kryesor të saj vijnë të formësuar e portretizuar përpara syve tanë. “Arti nuk ka me të njofshëm. Arti është dicka që

përjetohej nga të gjithë dhe qytetarët nuk janë naiv sa pushteti komunal i Vetëvendosjes mund t'i cilësojë. Përmendorja e Skënderbeut e shpallur para nesh është fyrie për vet ‘figurën e Skënderbeut por edhe për Prizrenin’, ka thënë më tej Hoxha.

Në fund, Eliza Hoxha ka thënë se memorialet dhe përmendoret e këtilla do të duhej të na mbushnin plot jetë e frymëzim për shkak të idealeve të larta dhe jetën e dhënë për liri dhe si të tilla ato janë jeta vet.

Ambasadori gjerman: Do ta mbështesim MKRS-në në realizimin e projekteve kulturore

PRISHTINË, 1 DHJETOR (ER)- Ministrja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi, ka pritur në takim, ambasadorin e Gjermanisë në Kosovë, Jorn Rohde, me të cilin ka biseduar për bashkëpunimin ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Ambasadës së Gjermanisë, në vendin tonë.

Ministrja Dumoshi ka falënderuar ambasadorin për mbështetjen e vazhdueshme, duke e vlerësuar lart ndihmën e pakursyer që ka dhënë Ambasada Gjermane për Kosovën. Po ashtu, ministrja Dumoshi e ka njoftuar ambasadorin Rohde për politikën dhe planet MKRS-së për zhvillimin e kulturës në vend, mbështetjen e rinisë përmes projekteve të ndryshme si dhe promovimin e diversitetit

kulturor. “Ambasada gjermane në Kosovë dhe Zyra e GIZ-it në kanë qenë dhe mbeten partnerë strategjikë të ministrisë tonë për të shtyrë përpara objektivat të cilat i mbulojnë dikasteret e MKRS-së e që i kontribuojnë Kosovës, në përgjithësi”, ka thënë ministrja Dumoshi.

Ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Jorn Rohde, ka njoftuar për gatishmërinë rreth projekteve në fushën e rinisë duke shprehur gatishmërinë e tij për të mbështetur rininë e vendit tonë përmes projekteve të ndryshme.

Ai po ashtu tha se do të mbështesë MKRS-në edhe në realizimin e projekteve konkrete në kulturë, trashëgimi si dhe do të ndihmojë avancimin e sportit në vendin tonë.



Bie pak numri i të infektuarve me Covid në Kosovë

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKshPK) ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit janë shënuar edhe dhjetë viktima nga Covid-19. Sipas IKshPK-së, nga 1 375 mostra të testuara, janë konfirmuar edhe 521 raste të reja me Covid. Në bazë të raportit, gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar edhe 585 pacientë, ndërsa raste aktive janë 13 505

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 1 DHJETOR - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKshPK) dhe laboratorët privatë janë testuar gjithsej 1 375 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i

kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 521 raste pozitive me Covid-19.

Brenda 24 orëve janë raportuar dhjetë raste të vdekjes me këtë virus.

Rastet e vdekjes janë nga komunat: Podujevë dy raste (81,75 vjeç), Prishtinë dy raste (83, 58 vjeç), Viti dy raste (77, 77 vjeç), Mitrovicë një rast (71 vjeç), Pejë një rast (79 vjeç), Junik një rast (83 vjeç), Rahovec një rast (78 vjeç).

Numri total i rasteve pozitive është 40 117 raste nga 145 363 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 1 026 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 585 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 25 586 raste, ndërsa numri i rasteve aktive është 13 505.

Rastet pozitive janë nga komuna Prishtinë 285 raste, Pejë 36 raste, Fushë-Kosovë 25



raste, Gjilan 25 raste, Gjakovë 21 raste, Ferizaj 16 raste, Podujevë 16 raste, Kamenicë 11 raste, Prizren 10 raste, Deçan 8 raste, Istog 8 raste, Drenas 7 raste, Suharekë 7 raste, Viti 7 raste, Klinë 6 raste, Mitrovicë 5 raste,

Rahovec 5 raste, Malishevë 4 raste, Skenderaj 4 raste, Lipjan 3 raste, Vushtrri 2 raste, Obiliq 2 raste, Kaçanik 2 raste, Dragash 2 raste, Hani i Elezit 2 raste dhe me nga 1 rast komunat Shtime dhe Novobërdë.

Gazetarja e "Epokës së re", Albulena Mavraj, fiton çmimin e parë për gazetari për energji dhe ambient

PRISHTINË, 1 DHJETOR (ER) - Gazetarja e rubrikës së ekonomisë në gazetën "Epoka e re", Albulena Mavraj, ka fituar çmimin e parë për gazetari, me temë nga fusha e energjisë dhe ambientit, me shkrimin "Kosova, deponi mbeturinash minerare që përhapin helm". Ky çmim është dhënë nga Instituti i Prishtinës për Studime Politike (PIPS) në bashkëpunim me GIZ-in gjerman në kuadër të programit për gazetarët që shkruajnë për në energji dhe për ambient.

Shkrimi "Kosova, deponi mbeturinash minerare që përhapin helm" ka trajtuar mbetjet minerare të cilat gjenden në ndërmarrjen "Trepça" tash e disa dekada. Me këtë rast, drejtoresha ekzekutive e PIPS-it, Leonora Kryeziu, ka thënë se ky shkrim

ka përmbushur kriteret e përcaktuara nga kjo organizatë.

Ajo ka deklaruar se shkrimi "Kosova, deponi mbeturinash minerare që përhapin helm" jep opsione për trajtimin e mbetjeve minerare. "Arsyet se pse i është dhënë çmimi i parë Albulena Mavrajt është sepse shkrimi i saj jep opsione për trajtimin e mbetjeve nga këndvështrime të ndryshme si në aspektin e vlerësimit monetar, trajtimin mjedisor, shitjen dhe trajtimin e tyre me teknologjinë më të re", është shprehur Kryeziu.

Në kuadër të programit për gazetarët në energji dhe ambient, PIPS-i ka ndarë edhe çmimin e dytë dhe të tretë. Çmimin e dytë e ka fituar gazetarja Dafina Lata, ndërsa të tretin gazetarja e "Ekonomia sot", Albulena Avdiu.



Limaj: Pa Thaçin, Krasniqin, Veselin, Selimin e të tjerët nuk do të kishte UÇK



PRISHTINË, 1 DHJETOR- Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, në emisionin "Debat" në RTK ka folur për procesin e tij gjyqësor në Hagë dhe proceset gjyqësore të EULEX-it, si dhe për zhvillimet në vend. "Pa këta njerëz, Thaçin, Krasniqin, Veselin, Selimin e të tjerët nuk do të kishte UÇK dhe pa UÇK nuk do të kishte liri", ka thënë Limaj. Ai ka theksuar se është gabim nga kushdo që i gëzohet shkuarjes së çlirimtarëve në Hagë. Sipas Limajt, ata janë në Hagë për të mbrojtur luftën çlirimtare. "Kjo nuk është punë

individësh. Kjo është për UÇK-në. Neve nuk mundet askush për të na ndalur që të flasim për padrejtësinë që po na i bëhet vendit tonë", ka thënë Limaj. Lideri i Nismës ka theksuar se institucionet e vendit duhet të bëjnë më shumë për t'i mbrojtur çlirimtarët në Hagë. Limaj ka bërë thirrje për unitet në këtë kohë. "Kurrë s'kam besuar se pas 15 viteve nis edhe një proces. Shërbimin më të madh na e bëjmë t'i kryejmë detyrat shtetërore. Kur jemi bërë bashkë, ka fituar Kosova, e sot po shohim garë me njëri-tjetrin", ka deklaruar Limaj.

KOSID publikon analizën ligjore mbi hidrocentralet në Kosovë “Shkeljet ligjore, që po shterin lumenj”

PRISHTINË, 1 DHJETOR (ER)- KOSID ka publikuar analizën ligjore 51 faqe të quajtur “Shkeljet ligjore, që po shterin lumenj”. Ky hulumtim adreson shkeljet ligjore që janë bërë me ndërtimin e hidrocentraleve në Parkun Kombëtar “Sharri” dhe “Bjeshkët e Nemuna” në periudhën e pasluftës. Analiza ligjore në të cilën është punuar pesë muajt e fundit, konfirmon përgjegjësinë e institucioneve të Kosovës, ZRRE-në dhe Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, si dhe dy kompanitë kryesore “Matkos Group” Sh.PK dhe KelKos Energy” Sh.PK. për këto veprime joligjore dhe shkatërruese ndaj ambientit të

Kosovës. “Për pasojë të politikave të gabuara mjedisore nga institucionet e Kosovës, ku këto dy kompani kanë pasur përfitime jolegjitime ekonomike duke përdorur resurset ujore të cilat janë publike, si dhe kanë ndërhyrë me punime në pronat private të banorëve të atyre anëve pa lejen e tyre dhe jashtë normave dhe kriterëve të lejuara me ligj”, është theksuar në komunikatën e KOSID.

Disa nga shkeljet të cilat hulumtimi i KOSID-it ka arritur t’i identifikojë, janë shkelje të ligjeve në fuqi të Republikës së Kosovës: Mospërfshirja e komunitetit në debate, konsultime e njoftime publike

me rastin e shqyrtimit të dokumenteve mbështetëse për lejimin e ndërtimit të hidrocentraleve; Mosinformimi me kohë, apo pengimi në qasje për informacion për pjesëmarrje në konsultime publike të komunitetit, si dhe pengim në qasje në dokumente publike; Mospërfshirje e komenteve, vërejtjeve dhe kërkesave për përmirësim të kriterëve dhe kushteve me rastin e lëshimit të akteve juridike (pëlqim, leje, licenca, etj) për ndërtimin e HC, nga institucionet publike; Mospërfshirja e drejtë i gjendjes reale të resurseve ujore dhe kushteve mjedisore me rastin e ndërtimit të HC-ve, si dhe

ndikimi i tyre në ndotjen, degradimin, shkatërrimin apo shterimin e resurseve ujore, si dhe dëmtimin e mjedisit (florës dhe faunës), natyrës, me rastin e përpilimit të raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis; Mosrespektimin e legjislacionit në fuqi me rastin e ndërtimit të HC, e posaçërisht atë të parqeve kombëtare dhe zonave të veçanta të mbrojtura, etj.

KOSID ka theksuar se ky hulumtim synon të jetë në shërbim të komunitetit dhe palëve të interesit të cilët mund t’i përdorin të gjeturat e këtij për të parandaluar keqpërdorimin e resurseve ujore, mbrojtjen e mjedisit dhe florës dhe faunës,

për të pajisur grupet e avokimit dhe banorët në luftën e tyre në mbrojtjen e interesit të tyre përmes institucioneve përgjegjëse, organeve të drejtësisë dhe gjykatave në Kosovë.

Po ashtu KOSID ka njoftuar se ka ndjekur çështjet lidhur me ndërtimin e hidrocentraleve për një kohë të gjatë dhe ka avokuar nëpërmjet debateve televizive, shkresave publike, takimeve me komunitetin e prekur direkt duke shërbyer si urë lidhëse mes komunitetit dhe institucioneve të Kosovës në mënyrë që të thirren në përgjegjësi ata që janë përgjegjës për degradimin e natyrës dhe abuzimit me resurse ujore.



Sivjet diaspora dërgoi afro 800 milionë euro në Kosovë

PRISHTINË, 1 DHJETOR- Me gjithë situatën e vështirë të krijuar nga Covid-19, diaspora shqiptare në Evropë dhe anekënd botës vazhdon të jetë krah i fortë për ekonominë tonë. Sipas të dhënave nga Banka Qendrore e Kosovës, në periudhën janar-tetor janë dërguar 90 milionë euro më shumë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Zëdhënës i BQK-së, Kushtrim Ahmeti, ka thënë se janë dërguar afro 800 milionë euro. “Gjatë periudhës janar-tetor 2020, vlera e dërgesave nga mërgimtarët arriti në shifrën prej 795.6 milionë euro apo 90 milionë euro më shumë se periudha e njëjtë e vitit 2019, ku totali i

remitencave ishte në vlerën prej 705.6 milionë euro. Nga kjo shumë 115.3 milionë janë të dërguara përmes bankave komerciale, 556.9 milionë nëpërmjet agjencive për transferim të mjeteve, ndërsa 124.2 milionë erdhën përmes kanaleve joformale siç është bartje e parave në xhepa”, ka thënë ai.

Ahmeti ka thënë se vetëm gjatë muajit maj janë dërguar rreth 104 milionë euro.

Sipas tij vitin e kaluar në muajin e njëjtë ishin dërguar 79 milionë euro.

Ai ka theksuar se vendet që prin për dërgesa janë shtetet gjermano-folëse. “Vlera më e madhe e remitencave të



dërguara gjatë këtij viti ishte muaji maj ku u dërguan 104 milionë euro, përderisa në majin e njëjtë të vitit paraprak, u

dërguan 78.4 milionë euro. Shtetet prej nga më së shumti janë dërguar remitencat prijnë shtetet gjermano folëse si

Gjermani, Zvicër, Austri, të përcjella nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Franca”, është shprehur ai.

Deponitë ilegale po shkatërrojnë mjedisin në Kosovë

Bazuar në shpërndarjen e deponive ilegale në rajone, Komuna e Prishtinës renditet e para me 582 deponi, pastaj Komuna e Prizrenit me 448, Komuna e Gjilanit 377, Komuna e Pejës 342 dhe Komuna e Mitrovicës 221 deponi

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 1 DHJETOR- Sipas kompetencave që dalin nga ligji për mbeturinat, si dhe aktet e tjera nënligjore Komunitat në Kosovë ende përballen me praninë e një numri të madh të deponive ilegale të mbeturinave që vazhdojnë të kërcënojnë mjedisin dhe shëndetin e qytetarëve.

Sipas të dhënave të grumbulluara prej raporteve ndër vite nga Agjencioni për Mbrojtje të Mjedisit në Kosovë rezultojnë rritje në shtrirje të shërbimit të grumbullimit të mbeturinave në nivel vendi ku nga 57.7 për qind në vitin 2016, në 70.9 për qind në vitin 2017 dhe 75.6 për qind në vitin 2018.

Gjithashtu, bazuar në të këto të dhëna dhe në bazë të raportimeve të komunave për vitin 2018 janë regjistruar 2 246 deponi ilegale të madhësive dhe llojeve të ndryshme. Krahasuar me vitin paraprak, edhe pse shtrirja e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave në nivel vendi ka pasur rritje, sërish vendi ynë përballen me numër të madh të

deponive ilegale në nivel vendi. Bazuar në të dhënat nga të gjitha komunat në Kosovë (për vitin referent 2018), pjesa më e madhe e deponive janë deponi të mëdha 39 për qind, deponi të mesme 32 për qind dhe të vogla 29 për qind, ndërsa lloji dominues i mbeturinave në këto deponi është 46 për qind mbeturina komunale, 37 për qind mbeturinat e ndërtimit dhe rrënim, 7 për qind mbeturina industriale dhe të rrezikshme, 4 për qind mbeturina të vëllimshme dhe 6 për qind mbeturina të tjera.

Bazuar në shpërndarjen e deponive ilegale në rajone, Prishtina renditet e para me 582 deponi, pastaj Prizreni me 448, Gjilani 377, Peja 342, Mitrovica 221 etj.

Edhe pse raporti i vlerësimit të gjendjes me mbeturina për vitin 2019 nuk është publikuar akoma, sërish sipas burimeve gjendja e mjedisit dhe prezenca e deponive ilegale mbetet dukuri problematike në nivel vendi.

Pajtim Kastrati koordinatör në organizatën Green Art Center (GAC), ka thënë se është me rëndësi që institucionet të



trajtojnë me seriozitet eliminimin e deponive ilegale duke ndërmarrë hapa adekuat nga niveli qendror dhe lokal në ndërtimin e sistemit të mirëfilltë të menaxhimit të mbeturinave dhe ngritjen e kapaciteteve sa i përket zbatimit të ligjit për të parandaluar hedhjen e mbeturinave.

Sipas tij, do të ishte shumë e rëndësishme që të gjitha komunat përmes veprimeve konkrete në një afat kohor sa më të shpejtë të rrisin shkallën e mbulimit me shërbim të

mbledhjes së mbeturinave në komplet territoret e tyre komunale.

Kjo sipas Kastratit, do të rezultonte në zvogëlimin e deponive ilegale të llojit të mbeturinave komunale. Gjithashtu, sipas tij hap tjetër mjaft i domosdoshëm do ishte edhe ofrimi i shërbimeve tek qytetarët nga kompanitë e licencuara për fraksionet e mbeturinave të vëllimshme dhe ndërtimore-rrënim. "Në këtë mënyrë do të zvogëlohej dukshëm numri i deponive

ilegale si dhe në anën tjetër ky fraksion i mbeturinave do të integrohej në një menaxhim adekuat prej grumbullimit deri në trajtimin përfundimtar si produkt i përdorshëm në industri të ndryshme", ka thënë ai.

Megjithatë, përkundër faktit që aspiratat e shtetit të Kosovës janë drejt integriteteve në BE, fatkeqësisht realiteti në Kosovë tregon se gjendja e mjedisit paraqitet e rënduar si pasojë e mungesës së sistemeve për menaxhim të integruar mbeturinave dhe zbatimit të ligjit.

Kontrata me 'Contour Global' shkon në arbitrazh

EPOKA E RE A. MAVRAJ

PRISHTINË, 1 DHJETOR- Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit e ka pranuar njoftimin nga Gjykata e Arbitrazhit Ndërkombëtar (International Centre for Settlement of Investment Disputes) përmes të cilit janë njoftuar për hapjen e kontestit me investitorin "Contour Global".

Më 24 maj 2020 ka qenë e paraparë që të bëhet mbyllja financiare e projektit termocentrali "Kosova e Re". Kjo nuk është arritur në kohë dhe pas dështimit të disa tentativave për zgjidhje të kontestit me marrëveshje, kërkesa për arbitrazh është parashtruar në Gjykatën e Arbitrazhit Ndërkombëtar nga investitori "Contour Global". Qeveria e Kosovës, përkatesisht Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, në bashkëpunim me Avokaturën e Shtetit ka marrë masa që ky



proces të ndiqet dhe çështja të mbrohet në mënyrën më të mirë të mundshme.

Qeveria e Kosovës në fund të vitit

2017 pati arritur marrëveshjen komerciale me kompaninë amerikane "Contour Global", për ndërtimin e Termocentralit

"Kosova e Re" me kapacitet 500 megavat.

Termocentrali "Kosova e Re" ishte paraparë të fillojë së

ndërtuari këtë vit, ndërsa të vihet në punë në vitin 2023 dhe ndërtimi i tij do të kushtonte 1.3 miliard euro.

Por, kompania amerikane Contour Global, e cila ishte përzgjedhur nga qeveria për ndërtimin e termocentralit, më 17 mars të këtij viti ka njoftuar se është tërhequr nga plani për ndërtimin e termocentralit.

Ish-ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Llluka, pati deklaruar në nëntor të vitit 2019 se nëse zvarritjet e kontratës me "Contour Global" shkaktohen nga Kosova duke mos i përmbushur obligimet, atëherë Qeveria e Kosovës do të ketë si përgjegjësi financiare ndaj kompanisë "Contour Global" një vlerë prej 19.7 milionë eurosh.

Ndërsa, sipas Lllukës, nëse Kosova i përfundon obligimet, por "Contour Global" nuk arrin të sigurojë pakon financiare, atëherë kjo kompani do t'i detyrohet Kosovës me një vlerë prej 17.5 milionë eurosh.

Vihet gurthemeli i çerdhes për fëmijë në rrugën 'Rexhep Bislimi'

FERIZAJ, 1 DHJETOR (ER)- Investimet në përmirësimin e infrastrukturës shkollore mbeten prioritete të qeverisjes lokale të udhëhequr nga kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu.

Ky i fundit bashkë me nënkryetarin Arton Gavazi, drejtorin e Urbanizimit dhe Mjedisit, Lulzim Aliu dhe drejtorin e Arsimit në Ferizaj, Afrim Llabjani, pritën në vizitë ministrin e Arsimit dhe Shkencës, Ramë Likaj, me ç'rast u vu edhe gurthemeli i çerdhes për fëmijë në rrugën "Rexhep

Bislimi" përkatësisht tek ish-Eurogoma, investim ky i Ministrisë së Arsimit në bashkëfinansim me Komunën e Ferizajt.

Tejet të rëndësishëm e vlerësoi këtë projekt i pari i Ferizajt, Agim Aliu.

Ai tha se me këtë projekt, Ferizajt po i shtohet edhe një institucion parashkollor, nga një sa kishte në fillim, gjersa tha se edhe pozicioni ky po ndërtohet ky institucion bën një balancë geografike mes institucioneve të tilla në qytet.

Ndërkaq ministri i Arsimit dhe

Shkencës, Ramë Likaj, duke përgëzuar Ferizajn për këtë projekt, tha se të tilla projekte do të mbështeten në vazhdimësi, me qëllim promovimin e nxitjen e përfshirjes së fëmijëve në institucionet parashkollore.

Projekti për ndërtimin e çerdhes së fëmijëve në rrugën "Rexhep Bislimi" është edhe një balancë geografike e shpërndarjes së institucioneve të tilla në zonën urbane, objekt ky që do të ketë 2 100 metër katror sipërfaqe, me 14 dhoma mësimi për fëmijë, kuzhinën dhe hapësirat tjera përcjellëse.



Në spitalin e Pejës vdes një i burgosur



PEJË, 1 DHJETOR (ER)- Shërbimi Korrektues i Kosovës ka njoftuar se të hënën në Spitalin Rajonal të Pejës, ka ndërruar jetë i burgosuri me inicialet H.B, viti i lindjes 1942. I burgosuri, rreth orës 16:50, të hënën, me rekomandim të

mjekut të Q.K Dubravë është dërguar në Spitalin Rajonal të Pejës, ku përkundër ofrimit të ndihmës mjekësore në Repartin e Kirurgjisë, i njëjti ka ndërruar jetë.

H.B po vuante nga hipertensioni arterial për çka

edhe po trajtohej në vazhdimësi nga mjekët e institucioneve korrektuese. I njëjti ishte i dënuar për veprën penale; vrasje. Organet kompetente janë duke i zhvilluar procedurat ligjore, ndërsa autopsia do të verifikoi shkakun e vdekjes.

Fillon së zbatuari propozimi i PDK-së në Prishtinë për transport publik falas

Prishtinë, 1 dhjetor (ER)- Asambleti i Partisë Demokratike e Kosovës (PDK) në Prishtinë, Leutrim Retkoceri, ka mbajtur konferencë për media, ku ka njoftuar se nga 1 dhjetori Komuna e Prishtinës fillon së zbatuari propozimin e PDK-së që trafiku urban të jetë falas për të gjithë qytetarët që udhëtojnë në kryeqytet. Retkoceri ka thënë se PDK-ja

ka propozuar që transporti publik të jetë falas për katër muaj, mirëpo komuna ka vendosur që ta zbatojë atë vetëm për muajin dhjetor. "Kjo, sepse nuk ka buxhet të miratuar për vitin 2021 nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Po ashtu, në projektbuxhetin e dërguar nga komuna një gjë e tillë nuk është e paraparë", ka thënë Retkoceri.



Fillon asfaltimi në segmentin e dytë të rrugës "Bujar Roka në Gjakovë"

GJAKOVË, 1 DHJETOR (ER)- Ka filluar asfaltimi në një ndër projektet më të mëdha infrastrukturore, në zonën e qytetit të Gjakovës.

Pjesa e dytë e rrugës "Bujar Roka" tashmë është në fazën e dytë të punimeve, gjë që shumë shpejtë do të kthehet në një ndër zonat me frekuentimin më të madh të komunikacionit rrugor brenda qytetit. Rreth tri kilometra gjatësi do të jetë pjesa që do të asfaltohet gjatë kësaj periudhe dhe gjithsesi që mbetet akoma

punë për të bërë deri në finalizim të projektit. "Ky projekt ka disa përparësi të jashtëzakonshme. Përfundimi i projektit do të sjell investime të mëdha në këtë pjesë, efektet e të cilit do të shihen në vitet në vijim. Punimet besojmë që do të finalizohen në mesin e pranverës së vitit të ardhshëm. Kemi rrugën që shkon përreth shtratit të lumit Erenik, në këtë projekt është paraparë që të rregullohet edhe shtrati i lumit", ka thënë Ardian Gjini, kryetar i Komunës së s.

Ai ka shtuar se në të njëjtën kohë parashihet edhe ndërtimi i një ure këmbësore e cila do ta zhvendosë qarkullimin e këmbësorëve nga qyteti në Shkugëz, prej rrugës ku ecin tani, nëpër trotuare të ndriçuar deri tek terrenet e tenisit.

Investimet që po bëhen janë përfitim afatgjatë në lehtësimin e jetës së qytetarëve duke rritur gradualisht hartën zonale të banimit dhe zhvillimit ekonomik në tërësi.



Hipokrizia e luftës në paqe përballë luftës për lirinë dhe shtetësinë e Kosovës

Fitim RIFATI

Lufta e shqiptarëve për çlirim e bashkim kombëtar gjatë shekujve XIX-XX, ka nxjerrë në pah personalitete të shquara, që me idealin dhe sakrificën e tyre kanë zënë vend të rëndësishëm në historinë e popullit shqiptar. Përgjatë këtyre shekujve, pothuajse në të gjitha fazat më të rëndësishme, që e kanë karakterizuar organizimin e luftës së armatosur për çlirim, janë paraqitur sfida serioze, të cilat kanë reflektuar në rezultatet e aksioneve dhe organizimeve ushtarake. Ato përfaqësojnë epokë e histori dhembjeje, lavdie e krenarie kombëtare. Në Kosovë, në periudha lufte e paqeje, personalitetet kryesore kombëtare janë përballur me fushata eliminimi fizik, politik dhe shoqëror, të orkestruara nga agjencitë e qarqe antishqiptare e antikombëtare.

Pushtimi, aneksimi dhe copëtimi i trevave shqiptare në shekullin XIX, kulmoi me formimin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, e cila në programin e saj kishte për synim mbrojtjen e tërësisë tokësore të viseve etnike shqiptare, afirmimin dhe realizimin e aspiratave politike e kombëtare. U shquan për angazhim maksimal Abdyl Frashëri, Ymer Prizreni, Sulejman Vokshi e shumë patriotë të tjerë nga të gjitha viset shqiptare. Përballë tre fronteve të luftës: fqinjëve serbë, malazezë e grekë; agresivitetit të Fuqive të Mëdha dhe Perandorisë Osmane, Lidhja Shqiptare e Prizrenit përçoi një mesazh brenda e jashtë viseve shqiptare mbi një fazë ndërgjegjësimit politik e kombëtar të shqiptarëve. Krerët kryesorë të saj u persekutuan, u internuan, u burgosën ose u ekzekutuan. Haxhi Zeka, në fundshekullin XIX dhe fillimshkullin XX, për arsye se po vepronte politikisht me platformën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, u vra me atentat. Së këndejmi, pas shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, Luftërave Ballkanike dhe Luftës së Parë Botërore, Isa Boletini u vra, sepse ishte aktiv dhe dëshironte çlirimin e Kosovës dhe një

Shqipëri politike, të bashkuar me të gjitha trevat etnike të saj. Njësoj, për këto arsye u vranë Bajram Curri e Hasan Prishtina. Veç tyre, shumë të tjerë u ekzekutuan, u burgosën, u internuan ose u dëbuan nga Kosova.

Gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore, qëndresa e shqiptarëve ndaj pushtuesve nuk u ndal dhe Lëvizja Kombëtare Shqiptare nuk u shua. Programet e kolonizimit, terrorit, spastrimit etnik, dëbimit me dhunë, asimilimit, vrasjeve dhe gjenocidit serbo-jugosllav në Kosovë, nuk arritën të shkatërronin fizionominë kombëtare e autoktone shqiptare. Aneksimi i dhunshëm i Kosovës nga ana e Serbisë më 1945 ngjalli lëvizje refraktare e të pandërprerë në Kosovë. Si përmes grupeve e organizatave të fshehta me karakter çlirimtar kombëtar, si përmes protestave e demonstratave popullore, si përmes veprimtarisë aktive politike, kulturore, shkencore e arsimore, u provua një lëvizje organike kombëtare shqiptare, e cila nuk pajtohej me regjimin hegjemonist serbo-jugosllav dhe politikën shoviniste të Serbisë ndaj shqiptarëve. Në këtë periudhë, nuk janë të rastësishme vrasjet ose eliminimet fizike të

personaliteteve të shquara të qëndresës shqiptare e të bashkimit kombëtar, si: Aqif Blytës, Shaban Polluzhës, Muharrem Fejzës, Sylë Zarbincës, Gjon Serreçit, Ajet Gërgurit, Idriz Gjilanit, Fazli Grajçevcit, Tahir Mehës, Vehbi Ibrahimit, Jusuf Gërvallës, Kadri Zekës, Bardhosh Gërvallës, Rexhep Malës, Nuhi Berishës, Zija Shemsiut, Ali Ajetit, Afrim Zhitisë, Fahri Fazliut e shumë veprimtarëve të tjerë. Megjithatë, presionet, persekutimet dhe dënimet e formave të ndryshme, përmes burgosjes e ekzekutimeve ndaj figurave patriotike të Kosovës brenda e jashtë saj, nuk e tundën idealin e lirisë, çlirimit dhe bashkimit kombëtar, i cili vazhdoi të mbetet aspiratë e forcave progresiste shqiptare me perspektivë kombëtare.

Në këtë kontekst, në dekadën e fundit të shekullit XX, vend meritore zë paraqitja e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), që kishte për synim të fundit çlirimin dhe bashkimin kombëtar të shqiptarëve. UÇK lindi dhe u formua si ushtri e popullit nga gjiri i forcave atdhetare, politike e përparimtare shqiptare, brenda e jashtë Kosovës. Ajo ishte forcë e organizuar ushtarako-politike me karakter dhe fizionomi

mbarëkombëtare, që për qëllim pati çlirimin e Kosovës nga pushteti arbitrar, ushtarako-politicor e violent serbo-jugosllav. Shqiptarët u bindën se luftën çlirimtare duhej ta zhvillonin duke u mbështetur në radhë të parë në forcat e tyre njerëzore e materiale dhe se duhej të punonin njëkohësisht për të siguruar përkrahjen e Fuqive të Mëdha më demokratike të botës, sidomos të atyre që kishin filluar të anonin në zgjidhjen e drejtë të çështjes së Kosovës, siç ishin ShBA-të dhe aleatët e saj evropian. UÇK-ja dhe lufta e saj e drejtë provuan para faktorit ndërkombëtar se populli shqiptar është i gatshëm të mbrojë trungun e tij dhe të sakrifikojë gjithçka vetëm të frymojë dhe zhvillohet i lirë në territorin e vet. Në këtë kontekst, shembulli më konkret, ndër rastet fenomen në historinë më të re të njerëzimit, ishte lufta dhe rënia heroike e Komandantit Legjendar të UÇK-së, Adem Jashari dhe familjes së tij në Prekaz, ndërsa në skenën e gjenocidit me masakrën e Reçakut dhe shumë masakra të tjera, u thye teza se shqiptarët do të mund të ekzistonin dhe jetonin të bashkuar dhe të dakorduar me aparatit shtetëror serbo-jugosllav, i cili zbatonte

gjenocid në të gjitha fushat e jetës kundrejt popullit shqiptar. Ndonëse ishte e vetmja forcë që mbrojti dhe u kujdes për popullsinë e pambrojtur, siç shprehej në atë kohë presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Bill Clinton, "NATO dhe UÇK-ja bënë që Millosheviqi të nënshtrohet". Prandaj, lufta e domosdoshme dhe e drejtë e UÇK-së, si dhe çlirimi i Kosovës, kanë paraqitur një të vërtetë të madhe e vlerë njerëzore në politikën botërore se atdhedashuria shqiptare nuk paraqet asgjë shoviniste, ekspansioniste a ksenofobe ndaj popujve e kombeve të tjera, por synon të afirmojë vlera krahas popujve dhe kombeve të përparuara.

Rrjedhimisht, sot, gjykimi i luftës çlirimtare shqiptare nga "drejtësia ndërkombëtare", përbën një akt paradoksal, ndërsa festimi i këtij akti në mjedise qarqesh politike e shoqërore shqiptare është skandal e turp kombëtar. Marrë për bazë historikun dhe kronologjinë e luftës çlirimtare në Kosovë, mund të supozohet se, në përputhje me standardet dhe mekanizmat modernë, po bëhet një përpjekje eliminimi e neutralizimi politik të simboleve të luftës çlirimtare dhe të shtetësisë së Republikës së Kosovës. Në këtë kontekst, midis të tjerash kemi të bëjmë me një hipokrizi koniunkturale të orkestrës politike e jopolitike, të luftës tradicionale në paqe përballë konformizmit dhe luftës për lirinë dhe shtetësinë e Kosovës. Mirëpo, historia do dëshmojë se përpjekjet e brendshme dhe të jashtme për demonizimin, asgjësimin ose neutralizimin e luftëtarëve të lirisë dhe të shtetësisë së Republikës së Kosovës, janë dhe do të mbesin gjithnjë anakronike. Si përfundim, denbabaden, politika gjenocidale serbe në Kosovë kishte për synim shkatërrimin e përmbajtjes dhe karakterit shqiptar. Prandaj, në të vërtetë, shqiptarët nuk kanë përjetuar periudha të mira nga Serbia dhe aleatët e saj, nuk përjetojnë aktualisht dhe është e pabesueshme se do të mund të përjetojnë në të ardhmen.



Haziri: Solidariteti në mbrojtjen e familjes, nënës dhe gruas, vlerë që duhet ta rrisim

GJILAN, 1 DHJETOR (ER)-Komuna e Gjilanit me një sërë aktiviteteve po e shënon muajin për parandalimin e dhunës në familje, apo Muajin e Portokalltë.

Kreu i Gjilanit, Lutfi Haziri, ka thënë se solidariteti në mbrojtjen e familjes, nënës dhe gruas, është vlerë që duhet ta rrisim, duke shtuar se Gjilani është shembulli më i mirë për parandalim të rasteve të dhunës në familje. "Maskat që po i shihni sot do

të përdoren për një muaj rresht, në kuadër të aktiviteteve për muajin kundër dhunës në familje apo Muajin e Portokalltë. Jemi ndër komunat e para që e ka ndërtuar Mekanizmin për parandalimin kundër dhunës në familje. Solidariteti në mbrojtjen e familjes, e nënës dhe gruas, është vlerë që duhet ta rrisim dhe t'i minimizojmë rastet eventuale të këtij problemi që e ka shoqëria shqiptare", ka thënë Haziri.

Në Ditën Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Gruas, më 25 nëntor, Zyra për Barazi Gjinore në kuadër të Njësisë për të Drejtat e Njeriut, i ka rekomanduar Drejtorisë së Arsimit që në të gjitha shkollat e Komunës së Gjilanit, gjatë kësaj periudhe, një orë mësimi t'i kushtohet informimit - ndërgjegjësimit për dhunën në baza gjinore, ku gratë dhe vajzat tona, fatkeqësisht i gjejmë viktimat të kësaj dhune.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Daci: Ndjenjë e mirë debutimi në një skuadër të huaj

“Kjo ka qenë ndeshja e parë për mua në garat ndërkombëtare, apo në një Superligë të Evropës. Ishte një ndjenjë e mirë dhe e veçantë për mua, për shkak se ishte ndeshja debutuese në një skuadër të huaj. Ka qenë një paraqitje e mirë, pasi për 23 minuta sa isha në lojë kisha 13 pikë, tetë kërcime, tre topa të vjedhur dhe një bllokadë”, ka thënë Saranda Daci

PRISHTINË, 1 DHJETOR - Një nga basketbollistët më të mira të Kosovës është Saranda Daci. Qendra e njohur bëri një kalim të bujshëm nga Bashkimi në Superligën e Çekisë, përkatësisht në skuadrën Slovanca MB. Ky ishte një kalim i bujshëm jo vetëm për Dacin, por në përgjithësi në basketbollin femëror të Kosovës. Ish-basketbollistja e Penzës dhe Prishtinës debutoi në fundjavë, duke lënë gjurmë për skuadrën e saj me 13 pikë e tetë kërcime. “Kjo ka qenë ndeshja e parë për mua në garat ndërkombëtare, apo në një Superligë të Evropës. Ishte një

ndjenjë e mirë dhe e veçantë për mua, për shkak se ishte ndeshja debutuese në një skuadër të huaj. Ka qenë një paraqitje e mirë, pasi për 23 minuta sa isha në lojë kisha 13 pikë, tetë kërcime, tre topa të vjedhur dhe një bllokadë. Ka qenë një ndeshje e vështirë, sepse kundërshtari është në top-4 të Superligës së Çekisë. Kam marrë besim se mund të jap edhe më shumë në ndeshjet tjera, edhe pse skuadra ime është me lojtare të reja 17-18 vjeçare”, ka thënë Daci për faqen zyrtare të FBK-së. Skuadra e saj pësoi nga Chomutov me shifrat 88:69.

Basketbollistja pejana ka folur për cilësinë në Superligën e Çekisë. “Basketbolli në Kosovë ka filluar të ngritët në cilësi dhe besoj që do të shoh edhe basketbolliste tjera në liga më të forta. Basketbolli në Çeki është shumë i organizuar, si brenda po ashtu edhe jashtë fushës”, ka shtuar tutje qendra e njohur, e cila ka fituar shumë trofe në basketbollin femëror në Kosovë. Ajo ka një mesazh për vajzat e reja në Kosovë që luajnë basketboll. “Për vajzat e reja, që kam dëshirë t’i thërrasë si gjenerata e artë ose më me fat se



e moshës time, ushtroni sa më shumë në skuadrat e juaja. Shkollohuni dhe edukoheni me një kulturë të mirë, sepse do të keni të ardhme të ndritur dhe do të përfaqësoni Kosovën në mënyrën më të mirë të mundshme”, ka shtuar Daci, e

cila pritet të jetë pjesë e Përfaqësueses A të femrave të Kosovës, që në vitin e ardhshëm do të marrë pjesë në FIBA Kampionatin Evropian për Shtete të Vogla. Kjo është hera e parë që Kosova A e femrave do të luajë në garat ndërkombëtare.

Cabanas: Boraci është ekipi më i mirë në ligën e Bosnjës



PEJË, 1 DHJETOR - Besa Famgas ka pasur shumë ndeshje javën e kaluar, ndërsa tashmë ka nisur përgatitjet për ndeshjet me Boracin e Banjallukës. Kampionia e Kosovës, Besa Famgas dhe Boraci takohen në raundin e tretë të Kupës Evropiane. Ndeshja e parë luhet menjëherë më 12 dhjetor në palestrën “Karagaçi” në Pejë. Ndeshja e kthimit është në

Banjallukë të Bosnjë-Hercegovinës më 19 dhjetor. “Boraci është ekipi më i mirë në ligën e Bosnjës. Mendoj se janë ndeshje të vështira. Ekipi kundërshtar ka pak përparësi pasi e luan ndeshjen e dytë në shtëpi. Boraci është ekip me lojtarë me përvojë, që ka mbrojtje të mirë 6:0 dhe 5:1 si dhe një portier të mirë. Nëse duam të fitojmë, duhet të luajmë shumë

fort në mbrojtje, të realizojmë kundërsulmet dhe mos të humbasim topin gjatë aksioneve të gjata. Për mendimin tim ky është çelësi”, ka thënë trajneri i Besa Famgas, Javier Cabanas. Në raundin e tretë të Kupës Evropiane luan edhe Prishtina që për kundërshtar e ka AEK-un e Athinës. Sipas orarit të publikuar në EHF të dy ndeshjet luhen në Athinë, më 19 e 20 dhjetor.

Unitedi e ka në dorë fatin e PSG-së

MANCHESTER, 1 DHJETOR (ER) - Skuadra e Manchester United është vetëm një pikë larg kualifikimit në mesin e 16 ekipeve më të mira në Ligën e Kampionëve. Klubi anglez e pret në “Old Trafford” nënkampionen e kësaj gare nga edicioni i kaluar, Paris Saint-Germain. “Djajtë e Kuq” aktualisht janë në krye të Grupit H dhe i duhet vetëm një barazim në njërin nga dy ndeshjet e fundit për të siguruar kualifikimin, derisa sonte duhet të jenë të kujdesshëm për faktin se PSG-ja kërkon “hakmarje” për humbjen në ndeshjen e parë (1-2), gjithashtu i duhet fitorja për të mbetur në garë për kualifikim. Unitedi në këtë



ndeshje hynë pas fitore se madhe kundër Southampton me rezultat 2-3. Në anën tjetër skuadra e PSG-ja duhet të shënon fitore në “Old Trafford” përndryshe do të ketë vështirë kualifikimin dhe nëse nuk arrihet një gjë e tillë do të ishte një dështim i madh për këtë klub, por

interesante do të zhvillohet edhe në Grupin E ku Sevilla dhe Chelsea luftojnë për pozitën e parë në grup, sepse të dy këto klube kanë nga dhjetë pikë. Krasnodar-Rennes luajnë për pozitën e tretë që e dërgon në Ligën e Evropës. Derbi i zjarrtë do të zhvillohet edhe

GRUPI E			GRUPI G		
18:55 Krasnodar - Rennes 21:00 Sevilla - Chelsea			21:00 Ferencvaros - Barcelona 21:00 Juventus - Dynamo Kyiv		
Tabela			Tabela		
1. Chelsea	4	10	1. Barcelona	4	12
2. Sevilla	4	10	2. Juventus	4	9
3. Krasnodar	4	1	3. Dynamo Kyiv	4	1
4. Rennes	4	1	4. Ferencvaros	4	1
GRUPI F			GRUPI H		
21:00 Borussia Dortmund - Lazio 21:00 Club Brugge - Zenit			18:55 I.Basaksehir - Leipzig 21:00 Manchester U. - PSG		
Tabela			Tabela		
1. Dortmund	4	9	1. United	4	9
2. Lazio	4	8	2. PSG	4	6
3. Club Brugge	4	4	3. Leipzig	4	6
4. Zenit	4	1	4. Istanbul B.	4	3

në Gjermani ku Borussia Dortmund e pret Lazion e Vedat Muriqit dhe Thomas Strakoshës.

Dortmundi ka 9 pikë, kurse Lazio ka 8 pikë dhe këto dy skuadra kërkojnë pozitën e parë në grup.



Ndërmarrja Publike Lokale "Prishtina Parking" Sh. A. Prishtinë



Në bazë të dispozitave të Nenit 21 të Ligjit Nr. 03/L-087 mbi Ndërmarrjet Publike, respektivisht dispozitat e Nenit 13 të Ligjit Nr. 04/L-111 për Ndryshim dhe Plotësim të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ndërmarrja Publike Lokale "Prishtina Parking" Sh. A. Prishtinë, shpall:

KONKURSET

Për pozitat:

I. Këshilltar/e i Përgjithshëm/Sekretar/e i Ndërmarrjes,

Kualifikimi dhe përgatitja profesionale

- Kandidati duhet të ketë diplomë në fushën e Fakultetit Juridik (Jurist i diplomuar ose Master në shkencë Juridike);
- Të posedojë së paku pesë (5) vite përvojë profesionale nga fusha e qeverisjes, korporatave ose të drejtës së shoqërive tregtare;
- Të plotësojë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1. si dhe të plotësojë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2. pikat (d), (f), (j), (k), (l), të ligjit nr. 03/L-087 të ndërmarrjeve publike dhe plotësim ndryshimit të ligjit për ndërmarrjet publike nr. 04/L-111 neni 13;
- Të posedojë njohuri të punës me kompjuter;
- Provimin e Jurisprudencës;
- Njohja e gjuhës angleze;

Detvat dhe përgjegjësitë

- Shërben si Sekretar i Bordit të Drejtorëve dhe është pikë qendrore e Komunikimit me Komisionin Komunal të Aksionarëve mbi funksionimin e ndërmarrjes NPL "Prishtina Parking" Sh. A.
- Të sigurojë përcjelljen e procedurave nga Bordi, ku bëjnë pjesë organizmi i takimeve të Bordit, Komitetet të Bordit dhe Aksionarëve dhe në bashkëpunim me Kryesuesin e Bordit bën përgatitjen dhe shpërndarjen e rendit të ditës.
- Të mbajë procesverbalin e takimeve dhe të shpërndaj ato tek Drejtorët dhe Komisionin Komunal të Aksionarëve.
- Të mbajë procesverbalin e secilës mbledhje të Bordit të Drejtorëve dhe Komisionit të Auditimit (nëse nuk kërkohet ndryshe nga Kryesuesi i tyre) dhe të regjistrojë ato në librin e protokollit.
- Vepron si agjent i ndërmarrjes për pranimin e njoftimeve, të bëjë sigurimin e rrjedhjes së mirë të informatave brenda Bordit, Komitetet të tij dhe në mes të Bordit dhe Menaxherëve të lartë të ndërmarrjes.
- Këshillat dhe shërbimet e Sekretarit të ndërmarrjes duhet të jenë në dispozicion të të gjithë Drejtorëve të Bordit dhe duhet të sigurojë që ato përputhen me procedurat e Bordit.
- Mirëmban regjistrat e të dhënave të ndërmarrjes.
- Përcjell ndryshimet ligjore, që kanë të bëjnë me ndërmarrjen duke informuar Bordin dhe Menaxhmentin e ndërmarrjes për ndryshimet si dhe përgatit udhëzime të nevojshme për Menaxhmentin në ndërmarrje.
- Kryen të gjitha arkivimet, publikimet dhe/ose zbulimet për autoritetet përkatëse, siç mund të kërkohet për ligjin për ndërmarrjet publike ose nga statuti i ndërmarrjes.
- Koordinon me KE-në përgatitjen e letrave (dokumente) për mbledhjet e Bordit të Drejtorëve.
- Merret me çështje tjera të qeverisjes së ndërmarrjes sipas nevojës.

Kohëzgjatja e punësimit, të drejtat dhe obligimet përcaktohen me kontratë punësimi në kohe të caktuar për tri (3) vite me mundësi vazhdimi.

Procedura e Konkurrimit

Kandidati-ja për pozitën Këshilltar/e i Përgjithshëm/Sekretar/e i Ndërmarrjes duhet t'i dorëzojë këto dëshmi:

- Aplikacionin;
- CV-në e Aplikantit;
- Dëshminë e Shkollimit (Fakulteti Juridik);
- Dëshminë për Përvojën e Punës (Trusti pensional);
- Referenca si dhe certifikatat tjera profesionale;
- Letër motivim;
- Deklaratën nën betim (merret nënshkruhet me rastin e dorëzimit të dokumentacionit);
- Certifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se tre (3) muaj);
- Kopjen e Lejes së Njoftimit.

II. Zyrtar/e Kryesor/e Financiar/e (ZKF) dhe i Thesarit,

Kualifikimi dhe përgatitja profesionale

- Shkollimi Universitar Fakulteti Ekonomik nga Fusha e Financave/kontabilitetit (Ekonomist i diplomuar ose Master në shkencat ekonomike);
- I Certifikuar me diplomë profesionale SCAA apo ACCA apo të ngjashme;
- Të posedojë përvojë profesionale mbi pesë (5) vite nga fusha e financave dhe kontabilitetit;
- Të ketë shkathtësi kompjuterike posaçërisht mbi sistemet e avancuara në fushën e financave/kontabilitetit;
- Të plotësojë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1. si dhe të plotësojë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2. pikat (d), (f), (j), (k), (l), të ligjit nr. 03/L-087 të ndërmarrjeve publike dhe plotësim ndryshimit të ligjit për ndërmarrjet publike nr. 04/L-111 neni 13;
- Njohja e gjuhës angleze;

Detvat dhe përgjegjësitë

- Është përgjegjës për zbatimin e të gjitha dispozitave financiare dhe standardeve të kontabilitetit, ligjet e aplikueshme në Kosovë të cilat rregullojnë çështjet financiare dhe aktet normative të ndërmarrjes;
- Organizon udhëheq dhe kontrollon punën e departamentit financiar;
- Mban përgjegjësi për pagesën e obligimeve financiare në pajtim me rregulloret financiare;
- Mban evidencë dhe dokumentacion të saktë për investimet dhe pagesat e ndërmarrjes;
- Përcjell dispozitat financiare në fuqi dhe literaturën profesionale dhe mban përgjegjësi nëse nuk aplikohen ligjet në fuqi;
- Kujdeset për pasurinë e ndërmarrjes, monitoron punën e komisioneve, kontrollon hyrje -daljet financiare në përgjithësi;
- Përcjell gjendjen financiare në banka dhe bashkëpunon me institucionet bankare dhe organet tjera në interes të ndërmarrjes;
- Përgatit llogaritë periodike dhe përfundimtare;
- Është përgjegjës për përgatitjen e transfereve bankare përkatësisht pagesave me dokumentacion mbështetës dhe siguron KE-në se pagesa është në rregull;

- Harton, zbaton dhe kontrollon zbatimin e procedurave financiare nga vartësit;
- Është përgjegjës të kontrollojë mbajtjen në rregull të arkivit të dokumentacionit të kontabilitetit dhe atij financiar;
- Zhvillon dhe zbaton rregullat e brendshme të kontrollit si dhe udhëzimet dhe procedurat për aktivitete si administrimi i buxhetit, menaxhimi i pasurive dhe detyrimeve dhe mbajtja e llogarive;
- Është përgjegjës për rregullsinë e proceseve në funksionin e kontabilitetit në kompani, përgatit dhe zbaton procedurat e kontabilitetit sipas ligjeve të aplikueshme në Kosovë, si dhe me kompetencë menaxhon resurset financiare të kompanisë brenda ligjeve dhe rregulloret të aplikueshme;
- Të përgatis të dhënat e ndërmarrjes për auditim;
- Mbanë përgjegjësi për kryerjen e regjistrimeve dhe barazimeve të pasurisë së Ndërmarrjes;
- Përgatit raportet periodike dhe vjetore të Ndërmarrjes për KE dhe Bordin e Drejtorëve.
- Ushtron kujdes për ecurinë e shpenzimeve të Ndërmarrjes, pagesën e obligimeve Ligjore dhe afarizmin e Ndërmarrjes;
- ZKFTH i raporton KE-së si dhe Bordit të Drejtorëve;
- Kryen edhe punë të tjera, për të cilat autorizohet nga KE dhe Bordi i Drejtorëve.

Kohëzgjatja e punësimit, të drejtat dhe obligimet përcaktohen me kontratë punësimi në kohe të caktuar për tri (3) vite me mundësi vazhdimi.

Procedura e Konkurrimit

Kandidati-ja për pozitën Zyrtar/e Kryesor/e Financiar/e (ZKF) dhe i Thesarit duhet t'i dorëzojë këto dëshmi:

- Aplikacionin;
- CV-në e Aplikantit;
- Dëshminë e Shkollimit (Fakulteti Ekonomik);
- Dëshminë për Përvojën e Punës (Trusti pensional);
- Referenca si dhe certifikatat tjera profesionale;
- Letër motivim;
- Deklaratën nën betim (merret nënshkruhet me rastin e dorëzimit të dokumentacionit);
- Certifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se tre (3) muaj);
- Kopjen e Lejes së Njoftimit.

III. Zyrtar/e për Auditim

Kualifikimi dhe përgatitja profesionale

- Shkollimi Universitar Fakulteti Ekonomik nga Fusha e Financave/kontabilitetit (Ekonomist i diplomuar ose Master në shkencat ekonomike);
- Përvoja e punës mbi pesë (5) vite në pozita menaxhuese të auditimit pas diplomimit;
- Të Jetë i licencuar për auditor (SCAAK, ACCA) apo të ngjashme;
- Njohja e gjuhës angleze;
- Njohja e mire e punës me kompjuter (MC Office)

Detvat dhe përgjegjësitë

- Rregullisht shqyrton gjendjen financiare të ndërmarrjes, kërkesat e planifikuara financiare dhe përmes vërejtjeve apo sugjerimeve njofton Komisionin e Auditimit kur e konsideron të nevojshme.
- Rregullisht e verifikon funksionimin e rregullt të kontrolleve të brendshme dhe nëse e konsideron të nevojshme njofton Komisionin e Auditimit përmes vërejtjeve apo sugjerimeve me shkrim.
- Rregullisht verifikon përshtatshmërinë dhe funksionimin e rregullt të sistemeve dhe procedurave të punës të cilat kanë për qëllim të sigurojnë se librat dhe dokumentacioni i ndërmarrjes duke përfshirë dokumentacionin financiar mbahen në pajtim me standardet e kontabilitetit dhe ligjet në fuqi. Kujdes të veçantë ushtron që projekt – deklaratat financiare vjetore të përgatit në mënyrë të rregullt dhe lidhur me këtë të raportoj Komisionit të Auditimit kur e konsideron të nevojshëm.
- Verifikon përshtatshmërinë dhe funksionimin e rregullt të sistemeve dhe procedurave të cilat garantojnë se ndërmarrja zbaton standardet dhe ligjet e aplikueshme në Kosovë gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj.
- Kryen vlerësim të pavarur të efikasitetit të politikave, procedurave dhe standardeve përmes të cilave bëhet menaxhimi i resurseve financiare, fizike dhe informative të ndërmarrjes.
- Përcakton llojin dhe tekniken e auditimit të brendshme për secilin rast konkret duke u bazuar në ligjet pozitive, aktet normative praktiken e mire dhe njohurit profesionale.
- Koordinon mënyrën e bashkëpunimit me auditorët e jashtëm dhe kujdeset që palët të jenë në dijeni, siguron dokumentacionin e nevojshëm dhe raporton për fushat gjegjëse, financiare dhe të prokurimit por duke pasur për bazë konfidencialitetin.
- Propozon masat që duhet të ndërmerren nga ndërmarrja për ngritjen e efikasitetit dhe zbatimit të rregullave gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj.
- Zbaton të gjitha rregullat dhe standardet të cilat kanë të bëjnë me auditimin e brendshme duke i raportuar KE-së, Komisionit të Auditimit dhe Bordit të Drejtorëve.
- Duhet të demonstroj integritet personal dhe profesional duke bashkëpunuar me menaxhmentin, Komisionin e Auditimit dhe KE-në.
- Kryen edhe punë të tjera për të cilat kërkohet nga menaxhmenti dhe Komisioni i Auditimit.

Kohëzgjatja e punësimit, të drejtat dhe obligimet përcaktohen me kontratë punësimi në kohe të caktuar për tri (3) vite me mundësi vazhdimi.

Procedura e Konkurrimit

Kandidati-ja për pozitën Zyrtar/e për Auditim duhet t'i dorëzojë këto dëshmi:

- Aplikacionin;
- CV-në e Aplikantit;
- Dëshminë e Shkollimit (Fakulteti Ekonomik);
- Dëshminë për Përvojën e Punës (Trusti pensional);
- Certifikatë për auditor të licencuar;
- Referenca si dhe certifikatat tjera profesionale;
- Letër motivim;
- Deklaratën nën betim (merret nënshkruhet me rastin e dorëzimit të dokumentacionit);
- Certifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se tre (3) muaj);
- Kopjen e Lejes së Njoftimit.

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë mbaruar shkollimin adekuat dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave.

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen në këtë adresë: **Komuna e Prishtinës (Objekti i vjetër), Rr. "UÇK", nr. 2, Prishtinë.** Kandidatët të cilët konkurrojnë duhet ta shënojnë saktë adresën dhe numrin e telefonit kontaktues, si dhe email adresën. Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për intervistë. Dokumentet e pa kompletuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen. **Konkursi është i hapur nga data: 01 Dhjetor 2020 – 21 Dhjetor 2020 ora 16:00.**

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “PemaEKO” SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. 810028200 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “PemaEKO” DO.O. donelo odluku o prestani rada sa nr. 810028200, ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the “PemaEKO” L.L.C. has come to the decision to quit its nr. 810028200 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.

**Republika e Kosovës**

Republika Kosova-Republic of Kosovo

*Qeveria -Vlada-Government*MINISTRIA E SHËNDETËSISË/ MINISTARSTVO ZDRAVSTVA/ MINISTRY OF
HEALTHAgjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale – AKPPM/
Kosovska Agencija za Lekove i Medicinska Sredstva – KALMS/Kosovo
Medicines Agency – KMA**Njoftim për zgjatje të afatit për aplikim në konkursin
për anëtarë të KVPPM-së, në AKPPM**

Ju njoftojmë se zgjatet afati për aplikim në konkursin për anëtarët e KVPPM-së në AKPPM edhe për shtatë (7) dite kalendarike, nga data 02-08.12.2020, i shpallur me 10.11.2020 në gazetën epoka e re, në vebfaqe të AKPPM-së, në tabelen e shpalljeve në AKPPM.

**Republika e Kosovës**

Republika Kosova-Republic of Kosovo

*Qeveria -Vlada-Government*MINISTRIA E SHËNDETËSISË/ MINISTARSTVO ZDRAVSTVA/ MINISTRY OF
HEALTHKosovska agencija za medicinske proizvode i opremu - PAKPM /
Kosovska Lencove agencija za medicinske proizvode - KALMS /
Kosovska agencija za lekove - KMA**Obaveštenje o produženju roka za prijavu na konkurs
za članove KVPPM, u KAMP**

Obaveštavamo vas da se rok za prijavu na konkurs za članove KVPPM u KMA produžava za još sedam (7) kalendarskih dana, od 02. 08. 12.2020., **Objavljenog 10.11.2020 u novinama Epoka e re, na veb lokaciji KAMP na oglasnoj tabli u KMA.**

Kur fakti politik bëhet pjesë e historisë, e në e vëzhgojmë atë me një distancë të ftohtë, Xhevdet Bajraj na e shpërndan atë të konvertuar në një fabul të shkëlqyer. *Cuando el hecho político pasa a formar parte de la Historia, y lo observamos con fría distancia, Xhevdet Bajraj nos lo entrega convertido en una espléndida fábula*

Héctor Carreto, poet, meksikan. - *Poeta mexicano*

Imazhet që ai evokon janë të pastra dhe të bukura, me pak njerëz, si plagë të thella e të pastra. Kur përktheja këto imazhe unë u përpoqa ta kap pafajësinë e tyre, bukurinë e tyre fëmijërore, e cila bie kaq shumë në kontrast me makthe të errëta të kujtesës së Bajrajt

Las imágenes que evoca son limpias y hermosas, con poca gente, como heridas profundas y limpias. Al traducir estas imágenes, intenté capturar su inocencia, su belleza infantil, que contrastan de manera tan marcada con las oscuras pesadillas de la memoria de Bajraj

Alice Whitmore, përkthyesë e poezisë së Bajrajt nga gjuha spanjolle në angleze, Australi. - *Traductora de la poesía de Bajrajt del español al inglés, Australia*

Zëri që na detyron t'i modifikojmë kategoritë tona dhe referencat ndaj dhunës, tmerrit, vdekjes, braktisjes, vetmisë, e cila në këtë Amerikën tonë Latine (kaq e prirë për të shpallur dhimbje që nga heroina e romantizmit) ka qenë pretexti i poezisë pamfletuese të oportunitetit lirik

Voz que nos obliga a modificar nuestras categorías y referencias para con la violencia, el horror, la muerte, el abandono, la soledad, que en esta nuestra Latinoamérica (tan proclive a anunciar el dolor desde la heroína del romanticismo) ha sido pretexto de panfletarias poetas de oportunismos líricos

Carlos Pineda, poet dhe eseist meksikan. - *Poeta y ensayista mexicano*

Poezia e Xhevdet Bajrajt nxit stuhi asociacionesh të lexuesit, e shkëput atë nga realiteti trivial dhe e strehon në një realitet të ri ku mbretëron meditimi për çështje substanciale të jetës, për botën, vetminë, dhimbjen dhe rrugëtimin e njeriut në jetë

La poesía de Xhevdet Bajrajt estimula la tormenta de asociaciones en el lector, lo separa de la realidad trivial y lo cobija en una nueva realidad donde reina la meditación sobre cuestiones sustanciales de la vida, sobre el mundo, la soledad, el dolor y el viaje del hombre en la vida

Zyrafete Shala, kritike letrare. - *Crítica literaria*

Poezi e dinjitetit mbi gërmadha. - *Poesía de dignidad sobre ruinas.*
Shqiptar Oseku, poet. - *Poeta*

6⁹⁹ €

9 789951 780094

KAFE ME NËNËN
CAFÉ CON MAMÁ

XHEVDET BAJRAJ



XHEVDET BAJRAJ

KAFE ME NËNËN poeziCAFÉ CON MAMÁ poesia

Parathënien/ Prólogo: Adil Olluri



Adem Gashi (1953), poet, prozator dhe eseist, pa lënë mënjane njohuritë e paskajshme të tij për letërsinë shqiptare dhe për atë botërore, ka kryer studimet për letërsi dhe gjuhë shqipe në Universitetin e Prishtinës. Ka punuar mësues dhe ka qenë redaktor

reviste, drejtor televizionit, themelues i PEN-it të Kosovës, kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës, bursist i fondacionit gjerman "Heinrich Böll-Stiftung", këshilltar i lartë politik, drejtor i Zyrës për Komunikim në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë. Është anëtar i revistës *Akademia* dhe anëtar i Këshillit Drejtues i Institutit Albanologjik. Ka botuar 24 libra dhe është nderuar me rreth 50 çmime letrare. Është prezantuar në dhjetë antologji të lirikës shqipe. Edhe pse që dy vjet ka mbushur moshën e pensionistit, krijimtarinë letrare s'ka ndër mend ta pensionojë.

Libri i katërt me tregime, me rrëfenja e me parabola i Adem Gashit, *Lakorja e fatit*, dëshmon dhe ridëshmon autorin si krijues po aq të fuqishëm edhe në prozë. Madje tani mund të vlerësohet se toka e begatë e shkrimtarit, në kuptimin cilësor të vlerave artistike dhe të hijeshisë dhe të kënaqësisë estetike, është tregimtaria.

Lakorja e fatit çilet me tregimin uverturë *Pëllumbi i paqes* i rimarrë nga libri me titullin omonim (*Pëllumbi i paqes*, 1989), për të lakuar strukturalisht tre kapitujt pasues: *Terr, Dritë dhe mjegull* dhe *Matanë*, të cilët, në aspektin e konceptimit mbarështrues të tyre, na e vizatojnë kurbën tematike dhe motive, ideore dhe përmbajtjesore, filozofike dhe psikanalitike jo vetëm të rrëfimitarisë tregimtare, por edhe të gjenit krijues të autorit. Në këtë rast, besoj, vlen të veçohen dy aspekte: poetika moderniste me elemente të postmodernizmit dhe gërshetimi i formave dhe zhanreve letrare siç, fjala vjen, i prozës (tregimi, rrëfenjat), i poezisë (një lirikë me dy parabola poetike dhe një rrëfenjë-parabolë) si dhe i dramës, i konceptuar në trajtë të antidramës (*Maja e gishtit të madh të perandorit*).

4⁹⁹ €

9 789951 780067

Dr. Emin Z. Emini

LAKORJA E FATIT

ADEM GASHI

ADEM GASHI

LAKORJA E FATIT
(Tregime, rrëfenja dhe parabola)

SHPALLJE

Biznesi SH.P.K "EURO ART" me numer Unik Identifikues Nr.810199704 , Shpallë njoftimin se bënë ndrrimin e STATUTIT te dates 01.12.2015. Duke plotësuar të dhënate reja si dhe korigjimin e gabimit te Stautit të më hershëm si:

- Ndërrimin e shumës së gjithëmbarshe të kapitalit themelorë fillestarë nga 500,000.€ ne 5,000.€
- Ndërrimi i Agjenti të regjistruar nga Bajram Haziri me Nr. ID. 1012566448. Tashë bëhet Ardit Haziri me Nr.ID.1240443933

NJOFTIM

Njoftojmë të interesuarit se me datën 10 dhjetor 2020 (e enjte) me fillim në orën 1300 Bsc. i dipl. Berat Feka mbron punimin e Masterit me titull: "Vlerësimi i cilësisë së silazhit në disa ferma në rajonin e Vushtrrisë". Mbrojtja publike do të jetë në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë në Prishtinë.

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Nezir Ahmeti nga fshati Prelloc, komuna Skenderaj, shpall të humbura dëftesat e shkollës fillore në Qirez.
- ▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Feja", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Feja" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalit më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- ▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- ▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- ▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- ▶ Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)
- ▶ Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.
- ▶ Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroji i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- ▶ Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.
- ▶ Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo, ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet. Për info: 045/699-221.
- ▶ Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.
- ▶ Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Ulpianë, tek Fontana në: E 30-3A, nr.27, kati -IV-. Çmimi sipas marrëveshjes në info: 044-132-368.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

